



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 689/113 prot.

Elbasan, më 12 /03.2025

**VENDIM**

Nr. 41 datë 12 /03/2025

**“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve me Karakter profesional, në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, si dhe në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Drejtësi” për vitin akademik 2025-2026”**

Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së “A. Xhuvani” neni 9, germa h, si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UE-së, Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në mbledhjen e datës 17.03.2025,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani” për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit me karakter profesional, ciklit të parë të studimeve Bachelor si dhe në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në “Drejtësi”, me kohë të plotë (Tabela 1 bashkëlidhur), **2310 kuota** të ndarë si më poshtë vijon:
  - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **2010 kuota.**
  - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **36 kuota.**
  - c) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë shtetas të huaj: **3 kuota.**
  - d) Kuota e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe egjiptianë: **28 kuota.**
  - e) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **83 kuota.**
  - f) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **150 kuota.**

2. Kuotat e perealizuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e; 1/f do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njësive kryesore të UE-së.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

